



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 08, datë 28.12.2020

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA LIBRAZHD, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 10, DATË 08.02.2017,
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 10, datë 08.02.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Librazhd”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.117 datë 23.12.2020, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Librazhd të miratuar me Vendimin Nr. 10, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e Rregullores së Planit:
 - *Shtimi i nenit 15/1 “Nënkategoritë e përdorimit të tokës”;*
 - *Shfuqizohet pika 2 e nenit 18;*
 - *Shtimi i nenit 18/1;*
 - *Paragrafi 4 i nenin 22 ndryshohet emërtimi nga “Devoll” në “Shkumbin”*
 - *Nenin 40, paragrafi 7;*
 - *Shtimi i nenit 43/1 “Rregullat për shtesat në lartësi në strukturat ekzistuese”;*
 - *Shtimi i nenit 43/2 “Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror”;*
 - *Shtimi i nenit 59/1 “Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm”;*
 - *Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore”.*

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Librazhd, bashkëlidhur këtij Vendimi.

Ngarkohen Bashkia Librazhd dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.

3. Ngarkohen Bashkia Librazhd, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

MEDIA TOTA

